



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 nëntor 2011
Nr. ref.: RK101/11

ATKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI-72/11

Parashtruesi

Elmi Dragusha

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 185/2008, të datës 6 janar 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Elmi Dragusha nga fshati Prugoc, Komuna e Obiliqit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 185/2008, të datës 6 janar 2011, i cili i është dorëzuar më 8 mars 2011.
3. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pohon se “Gjykata Supreme nuk i ka përcaktuar të drejtat sipas të cilave do të duhej të shiheshin kundërtëhëniet në mes të dëshmimeve materiale të të dy palëve”.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 maj 2011, parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata). Më 24 maj 2011, parashtruesi i kërkesës u njoftua që të kompletonte kërkesën, dhe më 2 qershor 2011, ai kompletoi dhe sqaroi kërkesën.
6. Ndërkohë, me rastin e kompletimit të kërkesës, parashtruesi i kërkesës, pa dhënë ndonjë arsyetim, ka kërkuar që të mos zbulohet identiteti i tij.
7. Më 24 qershor 2011, Gjykata informoi parashtruesin e kërkesës dhe gjykatat e përfshira, se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë lidhur me rastin KI-72-11.
8. Më 5 tetor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Almiro Rodrigues, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë refuzimin e kërkesës si të papranueshme.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 11 shkurt 2002, Qendra për Punë Sociale në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: QPS në Prishtinë), në të përditshmen „Koha ditore“ ka shpallur konkurs për vendin e punës të Zyrtarit për shërbime sociale në Qendrën për Punë Sociale në Obiliq (në tekstin e mëtejshëm: QPS në Obiliq), ku kërkohej që kandidatët të kenë shkollim të lartë universitar.
10. Në mesin e 9 kandidatëve të tjerë, parashtruesi i kërkesës ka aplikuar për postin. Megjithatë, pas procedurave të selektimit dhe rekrutimit, parashtruesi i kërkesës nuk u punësua.
11. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër vendimit të QPS në Obiliq. Më 23 janar 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazë.
12. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ndaj aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Më 20 maj 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, për shkak të zbatimit të gabueshëm të ligjit dhe ktheu rastin për rigjykim.

13. Më 27 shkurt 2007, në rigjykim Gjykata Komunale në Prishtinë përsëri refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazë.
14. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë. Më 19 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazë, dhe mbështeti Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Komunale në Prishtinë Cl. nr. 192/2005, të datës 27 shkurt 2007.
15. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për revizion ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Më 6 janar 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar si të pabazë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për revizion dhe mbështeti aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
16. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 185/2008, të datës 6 janar 2011, Gjykata Supreme pohon si vijon:

„.... nga procesverbali mbi vlerësimin e aftësive të kandidatëve nr. 18, i datës 15 mars 2002, vërtetohet se kandidati i cili ka të kryer Fakultetin Juridik dhe është vlerësuar me 43 pikë, është pranuar. Paditësi ka të kryer Fakultetin e Filozofisë dhe Sociologjisë dhe është vlerësuar me 21 pikë“.

„.... gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit ngase vendimi mbi pranimin e kandidatit është i ligjshëm, pasi që kandidati i pranuar është Jurist i Diplomuar dhe ka plotësuar kushtin e paraparë në konkurs...“

Faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pohon se “QPS në Obiliq (...) ka shpallur konkurs për pozitën e Zyrtarit të shërbimeve sociale për të cilën pozitë është e nevojshme të ketë kualifikime universitare përkatëse dhe jo, siç konsiderojnë gjykatat, se është i nevojshëm kualifikim superior universitar”.
18. Ai më tutje pohon se “nga interpretimi që [ai] i bëri konkursit, rezulton se detyrë e kandidatit me kualifikim përkatës është që të kryej analiza sociale, por është punësuar i diplomuari i cili sipas kualifikimeve kryen analiza/justifikime, çka nuk korrespondon me detyrat e shpallura në konkurs. Në konkurs është kërkuar që kandidati duhet të zgjidh raste sociale, e avokati nuk i kryen këto detyra”.
19. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se personi i përzgjedhur, duke qenë avokat, “nuk i plotëson kushtet dhe selektimi është kryer duke shkelur ligjin”.
20. Në fund, parashtruesi i kërkesës konkludon se më aktgjykimin e Gjykatës Supreme është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës.
21. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu konkludon se është shkelur neni 6.1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) . Neni 6.1 thotë:
“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile (...) çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm(...)”.
22. Parashtruesi i kërkesës më tutje thirret në nenin 13 të KEDNJ-së, i cili parasheh:

“Çdo personi të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqes një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”.

23. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese „që ta miratojë padinë e tij, anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 185/2008 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 588/2007, si dhe të kthejë lëndën për rigjykim në Gjykatës Supreme apo Gjykatën Komunale“.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pohon që neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) i Kushtetutës si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe e Drejta për zgjidhje efektive) janë bazë për kërkesën e tij.

25. Kushtet për pranueshmëri parashihen me Kushtetutë, specifikohen më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

26. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës thotë:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

27. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk duhet të veprojë si Gjykatë e Apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

28. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka argumentuar dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se pse dhe si neni 31 i Kushtetutës dhe 6 e 13 të KEDNJ-ës e mbështesin kërkesën e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

29. Parashtruesi i kërkesës pohon që të drejtat e tij ishin shkelur për shkak të konstatimit të gabuar të fakteve nga gjykatat më të ulëta dhe zbatimit të gabuar të ligjit, pa referenca specifike lidhur me atë se si këto vendime i shkelën të drejtat e tij kushtetuese.

30. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e vet dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit, që mendonte se ishte i gabuar, para Gjykatës Komunale, asaj të Qarkut dhe Gjykatës Supreme. Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr_17064/06, të 30 qershorit 2009).

31. Prandaj, rezulton që kjo kërkesë është qartazi e pabazë, në përputhshmëri me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës i cili parasheh se „Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:... b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 tetor 2011, njëzëri

VENDOSI

- i. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- ii. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- iii. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

